



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 143 Akti

Nr. 75 Vendimi

Tiranë, më 08.11.2018

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland</b>	<b>Ilia</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Xhensila</b>	<b>Pine</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Brunilda</b>	<b>Bekteshi</b>	<b>Relatore</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Elka Ermenkova, në Tiranë, më datë 08 nëntor 2018, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT :** **Znj. Miranda Nakaj**, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, përfaqësuar personalisht, dhe me avokaten znj. Brunela Kullolli, me numër licence 1503, të Dhomës së Avokatisë Tiranë, përfaqësuar me deklaram në seancë dëgjimore.

**OBJEKTI :** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE :** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;  
**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 96/2016** “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligjin nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisioneren Brunilda Bekteshi, dëgjoji subjektin e rivlerësimit Miranda Nakaj, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Miranda Nakaj, ka ushtruar funksionin e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, prej datës 10.06.2015.

2. Në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” parashikon se: *“Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio”*.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pozicionin e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe brenda datës 31.01.2017, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së, DSIK-së dhe KLD-së dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

3. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (me poshtë referuar si Komisioni), ka hedhur shortin, më datë 15 maj 2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqës nr. 1, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Roland Ilia dhe Brunilda Bekteshi. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisionere Brunilda Bekteshi. Me vendimin nr. 40, datë 16.07.2018, Komisioni vendosi që komisionerja Alma Faskaj, të zëvendësohet nga komisionere Xhensila Pine.

**4. Menjëherë me hedhjen e shortit**, trupi gjyqës, administroi: raportin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); raportin e vlerësimit profesional sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ( KLD).

**5. Me vendimin nr. 1, datë 24.05.2018,** trupi gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, znj. Miranda Nakaj, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupës, komisionerin z. Roland Ilia. Të gjithë anëtarët kanë deklaruar mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

**6. Me vendimin nr. 2, datë 26.11.2018,** trupi gjykues, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës si dhe vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj; (ii) t'i njoftojë subjektin të rivlerësimit se provat e administruara për këto tri kritere, kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, dhe t'i vendosë në dispozicion rezultatet e hetimit administrativ të hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurës Administrative.

**7. Më datë 02.11.2018 dhe datë 06.11.2018,** subjekti i rivlerësimit, njoftoi në rrugë elektronike dhe vuri në dispozicion të Komisionit, parashtrësë me pretendimet saj, si dhe shpjegime përfundimtare, të cilat u administruan nga ana e trupit gjykues.

**8. Me vendimin nr. 3, datë 05.11.2018,** trupi gjykues, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 07.11.2018, ora 10:00, pranë Pallatit të Koncerteve, Tiranë.

**9. Më datë 07.11.2018,** u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent, bashkë me përfaqësuesen ligjore, znj. Brunela Kullolli, me numër licence 1503, të Dhomës së Avokatisë Tiranë, përfaqësuar me deklaram në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar se i qëndronte shpjegimeve përkatëse të dërguara pranë Komisionit më datë 02.11.2018 dhe 06.11.2018, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 07.09.2018, për të rifilluar më datë 08.11.2018 për shpalljen e vendimit.

### **III. BASHKËPUNIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, SIPAS NENIT 48 TË LIGJIT NR. 84/2016**

Gjatë të gjitha fazave të hetimit, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

### **IV. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI LIDHUR ME VLERËSIMIN E PASURISË.**

#### **IV.1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja.**

Në përputhje me nenin 33 pika 5 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar raport të hollësishëm<sup>1</sup> dhe të arsyetuar me shkresën me nr. \*\*\*prot., datë 28.02.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së saj dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara prej tij.

Nga aktet e ILDKPKI-së, rezulton se subjekti është bërë subjekt deklarues në vitin 2010 kur ka punuar si Avokate Shteti, pranë Zyrës Vendore në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit dhe ka dorëzuar deklaratat periodike për periudhën 08.09.2010 - 15.04.2013. Më datë 25.01.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Vlerësimit Kalimtar, Vetting” pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

#### **IV.2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur, çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>1</sup>Shih, shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.02.2018, te dosja e ILDKPKI-së.

**Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në:** (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, me qëllim evidentimin e faktit nëse subjekti rivlerësimin arrin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të, si dhe nëse gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim kjo të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

### **Hetimi administrativ kryer nga Komisioni**

#### **I) Mbi asetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016.**

Referuar deklaratës së rivlerësimit kalimtar<sup>2</sup> të dorëzuar nga subjekti, më datë 25.01.2017, pranë ILDKPKI-së, e cila mban nr. indeksi \*\*\*, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, ka deklaruar si më poshtë:

**1.1. Kredi konsumatorë,** pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 810.000 lekë, me afat 84 muaj duke filluar nga data 19.03.2014 deri më datë 19.03.2021. Detyrimi i mbetur në shumën 545.813 lekë.

Komisioni, për vërtetimin e faktit kërkoi dhe administroi shkresën, nr. \*\*\* prot., datë 28.06.2018, nga “Raiffeisen Bank”, që konfirmoi kredinë në emër të subjektit të rivlerësimit.

**1.2. Kartë krediti,** pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën 500 euro. Detyrimi i mbetur në shumën 186 euro.

Komisioni, për vërtetimin e faktit kërkoi dhe administroi shkresën, nr. \*\*\* prot., datë 28.06.2018, nga “Raiffeisen Bank”, që konfirmoi kartë krediti në shumën 500 euro.

**1.3. Superkredi pranë “BKT”-së,** në shumën 500.000 lekë, e marrë me qëllim blerje kredie te “Raiffeisen Bank” dhe rregullime shtëpie duke filluar nga data 14.07.2016. Detyrimi i mbetur në shumën 456.997 lekë.

Komisioni, për vërtetimin e faktit kërkoi dhe administroi shkresën, nr. \*\*\*, datë 11.07.2018, nga “BKT”-ja, e cila konfirmon kredinë e marrë në shumën 500.000 lekë.

**1.4. Overdraft,** në shumën 78.000 lekë. Detyrimi i mbetur në shumën 78.000 lekë.

Komisioni, për vërtetimin e faktit kërkoi dhe administroi shkresën, nr. \*\*\*, datë 11.07.2018, nga “BKT”-ja, që konfirmon overdraftin.

**Në përfundim, lidhur me kreditë, kartë krediti, overdraft të deklaruara, Komisionit i rezultoi se deklaramet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar.**

---

<sup>2</sup>Deklarata “Vetting”, sipas shtojcës 2.

## **II) Mbi adresat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vite**

**2.1. Nisur nga konstatimi në raportin përfundimtar të ILDKPI-së**, nr. \*\*\*, datë 02.08.2018, “*se deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*”, dhe në këtë raport nuk evidentohet qartazi se më kë lidhet pasaktësia në deklaram, Komisioni kërkoi informacion shtesë nga ILDKPI-së.

**2.2.** ILDKPKI-ja me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 17.10.2018, ka informuar Komisionin se pasaktësia konsistonte në faktin se subjekti i rivlerësimit nuk kishte dekluar:

- a) të ketë në pronësi pasurinë e paluajtshme në adresën e sipërshënuar;
- b) të ketë marrë me qira pasurinë e paluajtshme në adresën e sipërshënuar;
- c) të ketë në posedim apo përdorim pasuritë e paluajtshme me adresat<sup>3</sup> e deklaruara në deklaratat periodike dhe në deklaratën “Vetting”, në seksionin “Adresa e plotë e regjistruar ku jeni të regjistruar në Gjendjes Civile” dhe “Nëse dispononi vendqëndrim”.

### **Faktet nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**2.3. Subjekti** i rivlerësimit është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2010, si dhe ka dorëzuar deklaratat periodike për periudhën 08.09.2010 - 15.04.2013, kur ka punuar si avokate shteti, pranë Zyrës Vendore në Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit.

**2.4. Në** deklaratën e interesave privatë, përpara fillimit të detyrës në vitin 2010 dhe në deklaratën e interesave privatë periodik të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit si adresë të plotë të regjistruar në gjendjen civile ka dekluar, këtë adresë, Lagjja: Nr. \*\*\*, Rr. “\*\*\*”,\*\*\*, Durrës.

**2.5. Komisioni**, konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, nuk kishte dekluar marrëdhënien, nëse e kishte pasuri në pronësi, qira, përdorim ose posedim, me këtë adresë banimi. Për këtë konstatim, Komisioni, kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit e cila<sup>4</sup> ndër të tjera deklaroi se kjo adresë i perkiste apartamentit në pronësi të prindërve të saj, z. P. F. N dhe znj. P. M. B, ku dhe subjekti kishte jetuar deri në datë 12 .04. 2011, datë në të cilën ky apartament ishte shitur.

**2.6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 11.07.2018, ka konfirmuar pronësinë e të atit të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Nakaj, mbi këtë apartament të blerë në vitin 2008 dhe të shitur në 12.04.2011.

**Lidhur me këtë adresë, Komisioni, konstatoi se nga informacioni i ardhur nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, banesa e mësipërme ka qenë në pronësinë e babait të subjektit të rivlerësimit, për rrjedhojë rezultoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti përputhen me dokumentacion e administruar.**

**2.7.** Në vijim lidhur me adresat, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën vjetore të vitit 2011, sipas certifikatës së gjendjes familjare është bashkë me prindërit. Nuk ka

<sup>3</sup> Në deklaratën “Vetting” ka dekluar adresë: Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*” dhe Rr. “\*\*\*\*”, \*\*\*, Tiranë. Referuar deklaratave të interesave private ndër vite, subjekti ka dekluar adresat: Lagjja: Nr. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”,\*\*\*, Durrës. Si dhe Komuna \*\*\* mbi \*\*\*, Tiranë.

<sup>4</sup>Për më tepër shih në dosjen e Komisionit, pyetësorin e datës 06.07.2018.

deklaruar asnjë pasuri të paluajtshme ose të luajtshme të regjistruar, ndërsa si adresë të plotë të regjistruar në gjendjen civile deklaroi, adresën: Komuna \*\*\*, \*\*\*, Tiranë.

**2.8.** Në deklaratën vjetore të vitit 2012, sipas certifikatës së gjendjes familjare rezultoi të jetë bashkë me prindërit. Nuk ka deklaruar asnjë pasuri të paluajtshme ose të luajtshme të regjistruar, ndërsa si adresë të plotë të regjistruar në gjendjen civile ka deklaruar, “Njësinë Nr. \*\*\*”, ndërsa si vend qëndrimi ka deklaruar, adresën: \*\*\*, Rr. “\*\*\*”, Tiranë.

**2.9.** Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë të plotë ku është regjistruar në gjendjen civile: Njësia administrative Nr. \*\*\*, Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, Tiranë, ndërsa si adresë vendqëndrimi: “Njësia Administrative, Nr. \*\*\*, Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, Tiranë.

**2.10.** Nga certifikata personale e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njesisë Bashkiake Nr. \*\*\*, datës 18.01.2017, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka vendbanim me adresë: Rr. “\*\*\*”\*\*\*, Tiranë.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni mbi adresat e konstatuara**

-Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, edhe me adresat e sipërpërmendura, nuk kishte deklaruar marrëdhënien nëse kishte pasuri në pronësi, qira, përdorim ose posedim.

Mbi këtë konstatim, Komisioni, më datën 06.07.2018, i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit e cila ndër të tjera deklaroi “...se babai i saj kishte apartamentin që kishte në Durrës në datën 12.04.2011, si dhe ka lidhur kontratë porosie në datën 30.04.2011, për një apartament të ndodhur në adresën, \*\*\*, \*\*\*, sot adresa e përditësuar (Rr. “\*\*\*”, \*\*\*, Tiranë). Duke pasur parasysh se nuk ishin kryer punimet përfundimtare të shtëpisë të apartamentit të mësipërm subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj jetuan për pak kohë në një apartament të një pallati tjetër të ndërtuar nga e njëjta shoqëri ndërtimi në adresën: Rr. “\*\*\*”\*\*\*, Tiranë, e cila në dijeninë e subjektit të rivlerësimit, ishte Rr. “\*\*\*”, referuar dhe pasaktësive të adresarit dhe emrave të rrugëve që ndryshonin vazhdimisht”. Subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj, fillimisht ishin regjistruar në Njësinë Administrative Nr. \*\*\*, dhe gjatë vitit 2017, znj. Miranda Nakaj, dhe familja e saj u regjistruan në Njësinë Administrative \*\*\*.

#### **➤ Mbi lidhjen e subjektit të rivlerësimit me këto adresa, Komisionit, gjatë hetimit administrativ i rezultoi se:**

1. Në përgjigjet e pyetësorit të parë, subjekti i rivlerësimit, bashkëlidh formularin e OSHEE-së mbi adresën e përditësuar (Rr. “\*\*\*”, Ndërtesa nr. \*\*\*, Hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, Tiranë).

2. Formulari i OSHEE-së, është dokument ligjor pasi me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 207, datë 16.03.2016, “Për ngarkimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh. a) si organ qendror blerës për kryerjen e procedurës së prokurimit publik për llogari të vet dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme” i ndryshuar. OSHEE-ja autorizohet të prokurorë fondin limit të përcaktuar në programin buxhetor “Shërbim i Gjendjes Civile” dhe fondin e saj të planifikuar OSHEE-së në cilësinë e organit blerës bashkërendon punën me Ministrinë e Punëve të Brendshme për procedurën e prokurimit, specifikimet teknike, testimin e tregut para publikimit

të tenderit dhe shqyrtimit të ankesave deri në njoftimin e shpalljes së fituesit. Referuar VKM-së, nr. 207, datë 16.03.2016, është plotësuar dokumenti/formulari i OSHEE-së, mbi adresën e përditësuar (Rr. “\*\*\*”, ndërtesa nr. \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* \*\*\*, Tiranë).

3. Nga certifikata personale e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njësisë Bashkiake Nr. \*\*\*, datës 18.01.2017, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka si vendbanim, Rr. “\*\*\*”\*\*\*, Tiranë.

4. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 20.07.2018, ka informuar Komisionin se në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. P. F. N, është regjistruar pasuria apartament, me nr. pasurie \*\*\*, \*\*\*, Tiranë.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. \*\*\*, datë 20.08.2018, ka informuar Komisionin se shtetasja Miranda Nakaj figuron të jetë e regjistruar banore në zyrën e Gjendjes Civile të Njësisë Administrative \*\*\*, Bashkia Tiranë, si dhe është shkëputur nga familja e origjinës, më datë 30.08.2013, duke rezultuar e vetme në përbërje familjare.

6. Nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ si dhe nga informacionet e ardhura nga institucionet përkatëse sa më sipër referuar, subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e saj fillimisht ishin regjistruar në Njësinë Administrative Nr. \*\*\*, dhe gjatë vitit 2017, rezultojnë të regjistruar në Njësinë Administrative \*\*\*.

7. Nga verifikimi *online* i adresave, rezulton se Rr. “\*\*\*” dhe Rr. “\*\*\*” ndodhen në Njësinë Administrative Nr. \*\*\*, ndërsa Rr. “\*\*\*” ndodhet në Njësinë Administrative \*\*\*.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm.**

**Komisioni, duke pasur parasysh faktet e dala nga hetimi i thelluar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ligjin e zbatueshëm, çmon se nuk ka dyshime për pasuri të paluajtshme në pronësi, përdorim, apo me qira, në lidhje me adresat e deklaruara ndër vite, dhe në deklaratën “Vetting” nga subjekti i rivlerësimit.**

### **III) Lidhur me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme**

Subjekti i rivlerësimit nuk deklaron në deklaratat periodike në periudhën 08.09.2010 - 15.04.2013 si dhe në deklaratën “Vetting” pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme në emër të saj.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**3.1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit**, është informuar nga Zyrat<sup>5</sup> Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, se në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, nuk ka asnjë pasuri të paluajtshme të regjistruar në regjistrat e tyre.

**3.2. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 02.07.2018**, Komisioni, u informua nga Drejtoria e Përgjithshme të Transportit Rrugor se subjekti i rivlerësimit nuk ka mjet në pronësi të saj.

**3.3. Me shkresën nr. \*\*\*, datë 06.07.2018**, institucioni i ALUIZNI-t, ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit nuk është subjekt aplikues për vetëdeklarim të ndonjë objekti informal.

<sup>5</sup> Refero në dosje, konfirmuar, nga 33 Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.



**3.4. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 06.07.2018,** Komisioni, u informua se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk ka kontratë furnizimi me energji elektrike, ndërsa në emër të babait të saj rezulton e regjistruar një kontratë furnizimi energjie për një apartament të ndodhur në Selitë, Tiranë.

**3.5. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 06.07.2018,** të UKT-së, Komisioni, u informua se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk ka kontratë furnizimi me ujë, ndërsa në emër të babait të saj rezulton e regjistruar një kontratë furnizimi me ujë për një apartament me adresë: Pallati “\*\*\*”, \*\*\*, Tiranë.

**3.6. Me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 20.07.2018,** të Ministrisë së Drejtësisë për çdo informacion të regjistruar në regjistrin noterial shqiptar, Komisioni, u informua mbi listën e veprimeve noteriale për subjektin e rivlerësimi, të cilat rezultuan vetëm dy vërtetime të njësisë me origjinalin.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm.**

Nga dokumentacioni i administruar, konfirmohet se në emër të subjektit të rivlerësimit nuk ka të regjistruar asnjë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme.

Me shkresën e ZVRPP-së Tiranë, nr. \*\*\*, datë 18.07.2018, rezultoi se në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. P. F. N, është regjistruar pasuria apartament, me nr. \*\*\*, në \*\*\*, Tiranë, blerë më datë 23.10.2011, apartament në të cilin jeton subjekti i rivlerësimit së bashku me prindërit.

Lidhur me këtë pasuri, Komisioni, konstatoi se në vitin 2011, kur është blerë apartamenti i ndodhur në, Rr. “\*\*\*”, ndërtesa nr. \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* \*\*\*, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, ka qenë me detyrë avokate pranë Avokaturës së Shtetit. Lidhur me këtë pasuri subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se nuk ka dhënë kontribut në blerjen e këtij apartamenti<sup>6</sup>. Subjekti rivlerësimit ka deklaruar se ka kontribuar në mënyrë simbolike në blerjen e pajisjeve shtëpiake si lavatriçe, televizor etj<sup>7</sup>.

**Në përfundim, trupi gjykues, çmon se dokumentacioni i administruar përputhet me deklarin e subjektit, nuk ka dyshime për pasuri të paluajtshme e të luajtshme të padeklaruara, në emër të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimet e saj janë bindëse dhe të plota.**

#### **IV) Lidhur me derdhjen në llogari të shumës 48.000 lekë nga shoqëria përmbarimore “Ardael”**

**4.1.** Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar se, më datë 21.12.2015, në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank” është derdhur nga shoqëria përmbarimore “\*\*\*” për kreditorin Z. S, shuma **48.000 lekë**, si ekzekutim titulli përmbarimor të vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 22.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**4.2.** Mbi këtë derdhje, subjektit të rivlerësimit, ka shpjeguar në deklaratën “Vetting” se kreditori Z. S, i cili është mik i familjes së saj, dhe se me mirëkuptim ishte përdorur llogaria bankare e saj.

<sup>6</sup>Për më tepër shih pyetësorin datë 03.07.2018.

<sup>7</sup>Për më tepër shih përgjigjet e pyetësorit në datën 03.07.2018.

**4.3.** Me qëllim verifikimin e faktit nëse subjekti i rivlerësimit gjendej në kushtet e konfliktit të interesit, Komisioni, i kërkoi subjektit kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 22.10.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**4.4.** Pas disponimit të vendimit, nr. \*\*\*, datë 23.06.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe vendimit, nr. \*\*\*, datë 22.10.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Komisioni, konstatoi se në këto vendime parashikohej, shuma 48.000 lekë, si ekzekutim titulli përbarimor për kreditorin Z. S.

➤ **Pas analizës së vendimit rezultoi se, znj. Miranda Nakaj, nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit pasi në kohën e dhënies së vendimit nuk ishte ndihmëse ligjore pranë gjyqtarëve të trupit gjykues që kanë dhënë vendimin, nr. \*\*\*, datë 22.10.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.**

#### **V) Të dhëna të tjera të dala gjatë hetimit administrative**

**5.1.** Komisioni gjatë hetimit të thelluar konstatoi se në përgjigje të pyetësorit standard subjekti i rivlerësimit deklaroi, hua në shumën 150.000 lekë në vitin 2011, nga shtetasi B. M. B (*daja i saj*), si dhe në dhjetor të vitit 2011, ish-nusja e vëllait u ka dërguar prindërve shumën prej 10.000 krunash (*afërsisht 1200 -1300 euro*) për arsye shëndetësore të nënës së saj, dhe për ti shlyer huan dajës.

**5.2.** Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume nga ana e z. B. B, Komisioni, kërkoi deklarime nga subjekti rivlerësimit, e cila ndër të tjera shpjegoi se: *“Duke filluar që nga data 14.01.2008 dhe në vazhdim daja im, B. M. B, ushtron aktivitet privat, i cili ka regjistruar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar “\*\*\*” sh.p.k, me aktivitet me objekt: Import, eksport, tregti me shumicë e pakicë artikuj ushqimorë, industriale, fruta, etj., provuar kjo me ekstraktin e QKB-së të lëshuar online nga faqja e QKB-së datë 10.10.2018”<sup>8</sup>.*

Deklarimin e saj subjekti i rivlerësimit e mbështet në dokumentacionin, kopje të pasqyrës financiare, me vulë tatimore viti 2011 të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k me ortak të vetëm z. B. B.

**5.3.** Më tej, për shlyerjen e kësaj huaje është përdorur shuma, prej 10.000 krunash afërsisht (*1200 -1300 euro*), të cilën ia dërguar ish-nusja e vëllait. Subjekti ka sqaruar ndër të tjera se : *“Unë nuk mund të provoj me dokumente burimin e shumës që ish-nusja e vëllait (të cilët në atë kohë jetonin bashkë), i kanë dërguar familjes time, pasi nuk kemi komunikim me të dhe familjen e saj që nga viti 2015”, dhe bashkëlidh deklarimit të saj dokumentin e datës 05.12.2015, nga ku ndër rezultoi se znj. Z. Q, ka kërkuar fillimin e procedurave të divorcit nga vëllai i subjektit të rivlerësimit.*

#### **VI) Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm.**

**6.1.** Trupi gjykues, duke pasur parasysh faktet e dala nga hetimi i thelluar, provat e administruara, si dhe ligjin e zbatueshëm, konstatoi se dokumenti pasqyra financiare viti

---

<sup>8</sup>Për më tepër shih përgjigjet e pyetësorit të datës 09.10.2018.

2011, konfirmuar me vulë të Drejtorisë Rajonale Tatimore, të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k me ortak të vetëm z. B. B, verifikuar *online* nga ekstrakti i QKB-së, nga faqja e QKB-së<sup>9</sup>, me aktivitet privat “*Import, eksport, tregti*” që prej vitit 2008, provon se huadhënësi (*daja e subjektit*), ka pasur mundësi financiarë të dhurojë huan në shumën 150.000 lekë në vitin 2011.

**6.2.** Lidhur me vërtetimin e burimit të ligjshëm të krijimit të shumës 10.000 kruna afërsisht (1200-1300 euro), të dërguara nga ish-nusja e vëllait, trupi gjykues çmon se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, mbështet arsyet saj se është në kushtet e pamundësisë objektive për të vërtetuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të ish-nuses së vëllait.

- **Në përfundim, lidhur me huan e deklaruar në pyetësonin standard, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit të mbështetura në dokumentacion ligjor vërtetojnë burimet e ligjshme të huadhënësit, në përputhje me nenin 32, të ligjit nr. 84/2016.**

### **Konkluzione për komponentin e vlerësimit të pasurisë**

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, eficientë dhe proporcionalitetit, në lidhje kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi analizoi dhe vlerësoi provat dhe shpjegimet e paraqitura, arrin në përfundimin se:

**Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit u konstatua se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse, të sakta dhe në përputhje me ligjin. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo fshehje të pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.**

## **II. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS**

**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\*, datë 09.07.2018, dërgon raportin për kontrollin e figurës të deklasifikuar plotësisht sipas të cilit konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj.

**Komisioni, lidhur me këtë kriter nuk i rezultoi ndonjë element dyshues mbi ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.**

**Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016.**

---

<sup>9</sup>Për më tepër shih përgjigjet e pyetësorit të datës 09.10.2018.

### **III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Sipas pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollën e Magjistraturës.

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” me shkresën nr. \*\*\*, datë 02.08.2018, ka dërguar raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

#### **I. GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA VETË SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit, ndihmësja ligjore Miranda Nakaj, më datë 26.01.2017, ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, aktet e mëposhtme:

- 1) Formulari i Vetëdeklarimit, gjithsej 5 (pesë) fletë;
- 2) 14 dokumente shoqëruese të formularit të vetëdeklarimit, gjithsej 31 (tridhjetë e një) fletë;

Fakti që subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, për periudhën e rivlerësimit, ka qenë ndihmëse ligjore e gjyqtarës B. H, u konfirmua verbalisht gjatë procedurës së shortit nga kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, si dhe nga 5 dosjet e përzgjedhura nga statistikat e dërguara për subjektin e rivlerësimit, ku relatore për çështjet ka qenë gjyqtarja B. H.

- 3) Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 3 relacione të cilat janë për çështje regjistruar brenda periudhës së rivlerësimit dhe përfunduar me vendim gjyqësor jashtë kësaj periudhe, konkretisht: 2 çështje janë të regjistruara në vitin 2015 dhe 1 çështje është e regjistruar në vitin 2016. 3 dokumentet ligjore, të përzgjedhur nuk lidhen me asnjë prej çështjeve të listuara në tabelat statistikore, mbi bazën e të cilave u organizua shorti për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore, që nënkupton se i përkasin çështjeve e gjyqësore jashtë periudhës së rivlerësimit.

## **Tre dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

**Dokumenti 1.** Relacion për çështjen administrative me nr. \*\*\*regj, datë 13.03.2015, që iu përket palëve ndërgjyqëse: paditës: L. Xh, kundër të paditurit: Qendra Shëndetësore Shupenzë, Komuna Shupenzë, rrethi Bulqizë, me objekt: Dëmshpërblimin nga marrëdhëniet e punës.

**Relacioni** rezulton të jetë i plotë, më tepër në kuptimin e një përshkrimi të vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës së Parë dhe parashtrimit të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala e paditur. Arsyetimi se ku është mbështetur Gjykata e Shkallës së Parë në vendimmarrje është paraqitur prej saj në mënyrë shumë të zgjeruar. Nuk ka mendim/sugjerim/rekomandim të ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes.

Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Në përmbajtje të relacionit nuk është përdorur referencë në fund të faqeve. Relacioni është 5 faqe, konceptuar nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk ka mendim të ndihmësit ligjor. Relacioni nuk tregon datën e përpilimit të tij.

**Dokumenti 2.** Relacion për çështjen administrative me nr. \*\*\* regj, datë 02.02.2015, që iu përket palëve ndërgjyqëse: paditës: Prefekti i Qarkut Tiranë, kundër të paditurve: H. L, B. L etj, person i tretë: ZVRPP-ja Kavajë, Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës, me objekt: Deklarimi i pavlefshmërisë dhe shfuqizimi i AMTP-së, nr. \*\*\*, datë 10.07.2003, për sipërfaqen 976 m<sup>2</sup>, në emër të z. H. L dhe kthimi i tokës në emër të pronarit shtet.

**Relacioni rezulton** të jetë i plotë, më tepër në kuptimin e një përshkrimi të vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës së Parë dhe parashtrimit të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala e paditur. Arsyetimi se ku është mbështetur Gjykata e Shkallës së Parë në vendimmarrje është paraqitur prej saj në mënyrë shumë të zgjeruar. Nuk ka mendim/sugjerim/rekomandim të ndihmësit ligjor për zgjidhjen e çështjes.

Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Në përmbajtje të relacionit nuk është përdorur referencë në fund të faqeve. Relacioni është 6 faqe, konceptuar nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk ka mendim të ndihmësit ligjor. Relacioni nuk tregon datën e përpilimit të tij.

**Dokumenti 3.** Relacion për çështjen administrative me nr. \*\*\* regj, datë 01.02.2016, që iu përket palëve ndërgjyqëse: paditës: S. N, kundër të paditurve: Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe DRSSH-së Tiranë, me objekt: Shfuqizimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 26.06.2015, për mbylljen e pensionit, detyrimin për ta lidhur pensionin e pleqërisë etj.

**Relacioni** rezulton të jetë i plotë, më tepër në kuptimin e një përshkrimi të vendimmarrjes së Gjykatës së Shkallës së Parë dhe parashtrimit të pretendimeve të ngritura në ankim nga pala e paditur. Arsyetimi se ku është mbështetur Gjykata e Shkallës së Parë në vendimmarrje është paraqitur prej saj në mënyrë shumë të zgjeruar. Nuk ka mendim/sugjerim/rekomandim të ndihmësit ligjor.

Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive. Në përmbajtje të relacionit nuk është përdorur referencë në

fund të faqeve. Relacioni është 7 faqe, konceptuar nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk ka mendim të ndihmësit ligjor. Relacioni nuk tregon datën e përpilimit të tij.

## **II. PËRSHKRIMI I 5 DOKUMENTEVE LIGJORE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT**

Gjetjet nga vëzhgimi i këtyre 5 dosjeve përshkruhen më poshtë.

**Dokumenti 4.** Çështja administrative, nr. \*\*\*regj. themeltar, që iu përket palëve ndërgjyqëse: paditës: N. Gj, kundër të paditurit: Bordi i Kullimit Lezhë, me objekt: Kthim në punë, e **përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.06.2016.**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 07.07.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur.

**Dokumenti 5.** Çështja administrative, nr. \*\*\* regj. themeltar, që iu përket palëve ndërgjyqëse: paditës CEZ Shpërndarje, sh.a, kundër të paditurit Inspektoratit Shtetëror të Punës, Qarku Kukës, me objekt: Pavlefshmëri titulli ekzekutiv vendimi i datës 08.03.2010 për dënimin me gjobë, e **përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.09.2015**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.10.2012, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala paditëse.

**Dokumenti 6.** Çështja administrative, nr. \*\*\* regj. themeltar, që iu përket palëve ndërgjyqëse, paditës: A. N., kundër të paditurit: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me objekt: Dëmshpërblim page, e **përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.05.2016.** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3183, datë 13.06.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala paditëse.

**Dokumenti 7.** Çështja administrative, nr. \*\*\* regj. themeltar, që iu përket palëve ndërgjyqëse: paditëse: N. A., kundër të paditurve: ISSH-së Tiranë e DRSSH-së Elbasan, me objekt: Anulim vendimi nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, detyrim pagim pensioni, e **përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.09.2016**

**Dokumenti 8.** Çështja administrative, nr. \*\*\*regj. themeltar, që iu përket palëve ndërgjyqëse: paditës: A. T., kundër të paditurit: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, me objekt: Anulimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 22.11.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, kthimin në punë e pagimin e pagës nga dita e largimit deri në datën e rikthimit në punë etj, e **përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.07.2016.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.06.2013, ka vendosur pranimin e kërkesë padisë. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.04.2014, ka vendosur moskompetencën e Gjykatës së Apelit Durrës për gjykimin e çështjes dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Apelit si gjykatë kompetente.

Nga aktet e vëna në dispozicion, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, Gjykata e Lartë, si dhe nga vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 31.07.2018, i kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe në bazë të nenit 6 të ligjit nr. 49/2012, rezulton se në 5 dosjet gjyqësore:

- a) Nuk është përfshirë ndonjë akt, që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin, që ndihmësja ligjore Miranda Nakaj, i ka dhënë gjyqtarës B. H, lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor;
- b) Nuk është përfshirë përgatitja e ndonjë projekt-akti procedural të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej ndihmëses ligjore Miranda Nakaj;
- c) Nuk është përfshirë ndonjë kërkesë nga gjyqtarja B. H drejtuar ndihmëses ligjore për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, në dosje nuk ka ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja Miranda Nakaj.

## **1. Aftësitë profesionale**

### **a) Njohuritë ligjore**

Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, ka njohuri ligjore të cilat konfirmohen nga angazhimet e saj akademike ndër vite dhe detyrat e ushtruara. Pas marrjes së titullit “Juriste” në vitin 2003, ajo ka përfunduar “Master të nivelit të dytë” në Shkencat Juridiko-Penale në Universitetin “Justiniani i Parë”, Fakulteti i Drejtësisë Tiranë në vitin 2011, si dhe Master i Shkencave në “Legjislacion dhe Institucionet Evropiane” në Institutin e Studimeve në vitin 2015. Ka marrë pjesë vetëm në një trajnim në Shkollën e Magjistraturës lidhur me zhvillime të legjislacionit të prokurimeve publike dhe atij fiskal në këndvështrimin e gjykimeve administrative, çka lidhet me detyrën e ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative. Gjithashtu dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ndonëse janë jashtë periudhës, konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën administrative, që lidhen me llojin e detyrës që ajo ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit - ndihmëse ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit.

Vlen të evidentohet se 3 dokumente ligjore të paraqitura prej saj janë jashtë periudhës së rivlerësimit. Ky fakt u konfirmua nga statistikat e paraqitura për ndihmësen ligjore Miranda Nakaj, si dhe verbalisht gjatë procedurës së shortit. Këto 3 dokumente tregojnë se ajo ka trajtuar mosmarrëveshje që lidhen me dëmshpërblimin nga marrëdhëniet e punës (*shih* dokumentin 1), vlefshmërinë e titujve të pronësisë nga zbatimi i ligjit “Për tokën” (*shih* dokumentin 2) dhe procedurën administrative të të drejtës së pensionit (*shih* dokumentin 3).

Për sa i përket 5 dosjeve të vëzhguara, rezulton se në to nuk ka asnjë akt të përgatitur nga subjekti i rivlerësimit, për këtë arsye iu kërkua informacion kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit të konfirmonte, nëse ka akte të tjera procedurale të hartuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat nuk janë administruar në 5 dosjet e përzgjedhura me short. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.07.2018, kryetari i gjykatës bën me dije se nuk ka asnjë akt tjetër procedural të hartuar nga ndihmësja

ligjore, i cili nuk është administruar në dosjet gjyqësore të përzgjedhura në procedurën e shortit. Për informacionin e dërguar është marrë edhe mendimi i vetë subjektit të rivlerësimit.

b) Arsyetimi ligjor

3 dokumentet ligjore të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit janë të shkruar qartë dhe në mënyrë të kuptueshme me strukturë të mirëorganizuar, por në to nuk ka mendim të ndihmësit ligjor. Ndërkohë në 5 dosjet e vëzhguara, të përzgjedhura me short, nuk ka asnjë dokument ligjor të përgatitur nga subjekti, për këtë arsye aftësia për arsyetimin ligjor nuk mund të konfirmohet as nga 5 dosjet e vëzhguara.

Në 3 dokumentet ligjore është konstatuar se ato janë akte formale, përmbajnë strukturën e detyrueshme ligjore, por nuk tregojnë mendimin, sugjerimin apo rekomandimin e ndihmësit ligjor.

Karakteristikë e relacioneve është pasqyrim i detajuar i linjave kryesore të arsyetimit të vendimit të përdorura nga gjykata e faktit, si dhe qëndrimet e gjykatës lidhur me pretendimet kryesore të palëve. Në asnjë dokument nuk evidentohet përdorimi i parimeve të përgjithshme të teorisë të së drejtës, analizë apo referim në jurisprudencën përkatëse në rastet e relatuara. Rrjedhimisht, këto akte kanë natyrë deskriptive dhe lehtësojnë punën mekanike të gjyqtarit.

## 2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, në periudhën e rivlerësimit, 10.06.2015 - 08.10.2016, ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore gjyqtares pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Në funksionin e ndihmësit ligjor pranë kësaj gjykate ajo ka deklaruar se në periudhën, 10.06.2015 - 31.12.2015, ka përfunduar 138 draft relacione, ndërsa në periudhën, 01.01.2016 - 08.10.2016, ka përfunduar 512 draft relacione.

Ndërsa sipas informacionit zyrtar të paraqitur të paraqitur nga Gjykata Administrative e Apelit për efekte të organizmit të përzgjedhjes së 5 çështjeve me short, rezultojnë të relatuara 397 çështje.

Duhet evidentuar fakti se për subjektin e rivlerësimit nuk ka të dhëna direkt për ngarkesën dhe punën e saj, por të dhënat janë nxjerrë nga dosjet gjyqësore të gjyqtarit pranë të cilit është emëruar ndihmësi ligjor.

Referuar të dhënave nga 5 dokumentet e përzgjedhura me short, tek të cilat nuk kanë akte relatimi dhe as projektvendime të konceptuara zyrtarisht nga ndihmësja ligjore, rezulton se nga data e shpalljes së vendimit deri në dorëzimin e vendimit të arsyetuar në sekretarinë gjyqësore kanë kaluar 21 ditë (*shih dokumentin 4*), 28 ditë (*shih dokumentet 5*), 3 ditë (*shih dokumentet 6*), 22 ditë (*shih dokumentin 7*) dhe 13 ditë (*shih dokumentin 8*). Në 4 raste, është tejkaluar afati ligjor 7 ditor i përcaktuar nga neni 42/3 i ligjit nr. 49/2012 (*shih dokumentet 4, 5, 7 dhe 8*). Edhe në analizën e këtij treguesi, duhet evidentuar se nuk mund të identifikohet nëse shkak kryesor i vonesës është mospërmbushja e detyrave nga ndihmësi ligjor sipas nenit 6 të ligjit nr. 49/2012.



Në analizën e këtyre të dhënave duhen evidentuar tre faktorë: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar numrin e çështjeve për relativitet që i janë caktuar dhe rrjedhimisht, rendimenti i punës së saj nuk mund të përcaktohet; (ii) kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës Administrative të Apelit; (iii) mungesa e të dhënave mbi kohën e caktimit të çështjeve për përgatitje dhe e datës së përfundimit të relacionit nga ndihmësja ligjore, bën të pamundur llogaritjen e kohëzgjatjes së secilit relacion të ndihmësës ligjore të përzgjedhur me short për vlerësim.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga të gjitha praktikatat e administruara nuk ka dokumentim të veprimeve të kryera nga ndihmësi ligjor, me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie. Nga përmbajtja e 3 dokumenteve ligjore konstatohet se në çdo rast, ndihmësja ligjore ka studiuar çështjen gjyqësore që ka relatuar në shkallën e parë të gjykimit, duke identifikuar disponimet e gjykatës më të ulët, thelbin e analizës ligjore, si dhe shkaqet e ankimit. Këto veprime ajo i ka materializuar në relacionin ligjor i cili është konceptuar nga subjekti dhe përgjithësisht përmbajnë elementët proceduralë të kërkuar në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012.

Në 5 dosjet e vëzhguara nuk mund të nxirret asnjë e dhënë lidhur me aftësinë për të kryer procedurën gjyqësore të ndihmësës ligjore, pasi nuk ka asnjë akt të përgatitur sipas parashikimeve të nenit të sipërcituar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Në 5 dosjet e përzgjedhur me short, nuk është përfshirë ndonjë akt, që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin, që ndihmësja ligjore Miranda Nakaj, i ka dhënë gjyqtarës B. H lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, për përgatitjen e ndonjë projekt-akti procedural të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej ndihmësës ligjore Miranda Nakaj, si dhe ndonjë kërkesë nga gjyqtarja B. H drejtuar ndihmësës ligjore, për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, në dosje nuk ka ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja Miranda Nakaj.

Nga verifikimi i 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti konstatohet se ato nuk kanë datë përpilimi dhe janë nënshkruar vetëm në fund nga ndihmësi ligjor, me rekuizitën “konceptoi”. Tregojnë emrin e gjyqtarës, por nuk mbajnë nënshkrimin e saj. Gjithashtu edhe Formulari i Vetëvlerësimit profesional është i plotësuar rregullisht. Ajo ka nënshkruar vetëm me firmë të mbyllur, pa shënuar emrin dhe mbiemrin, duke e shënuar të plotë vetëm në fund të formularit (faqe 4).

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

a) Etika në punë

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, konstatohet se në periudhën, prill 2006 - shtator 2010, subjekti ka deklaruar periudhë si e vetëpunësuar avokate në Durrës. Në periudhën, shtator 2010 - prill 2013, ka ushtruar detyrën e Avokates së Shtetit, Zyra Vendore Tiranë. Në periudhën, prill 2013 - qershor 2015, ka ushtruar detyrën e inspektore në

Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në periudhën qershor 2015 e aktualisht ushtron detyrën e ndihmëses ligjore, pranë Gjykatës Administrative Tiranë. Në Këshillin e Lartë të Drejtësisë nuk ka të dhëna nga burimet arkivore.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore (jashtë periudhës së rivlerësimit) të paraqitura nga vetë subjekti nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj.

Në 3 dokumentet ligjore (jashtë periudhës së rivlerësimit) nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Ndërsa, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo çështje që lidhet me pakicat. Po ashtu, në këto 3 dokumente ligjore (jashtë periudhës së rivlerësimit) nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Për sa i përket 5 dosjeve të vëzhguara, duhet ritheksuar se në to nuk ka asnjë akt procedural që i përket subjektit të rivlerësimit.

#### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

a) Aftësitë e komunikimit

Në 3 dokumentet ligjorë, nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, me palët ndërgjyqëse pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta, ndërsa gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore, i qartë dhe i saktë. Në të 3 dokumentet ligjore, gjuha e përdorur në akte është normale.

Për sa i përket 5 dosjeve të vëzhguara, duhet ritheksuar se në to nuk ka asnjë akt procedural që i përket subjektit të rivlerësimit.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore (jashtë periudhës së rivlerësimit) nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë në asnjë prej relacioneve të vëzhguara nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e saj me gjyqtaren e Gjykatës Administrative të Apelit pranë të cilës ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore. Mungesa e dokumentimit të akteve, si dhe mungesa e kërkesave të gjyqtares për kërkim ligjor nga ana e ndihmëses ligjore në 5 dosjet e vëzhguara, janë tregues indirekte për këtë aspekt.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, ka deklaruar se gjatë punës si ndihmëse ligjore është specializuar në fushën e të drejtës administrative. Ajo ka marrë titullin “Jurist” në vitin 2003. Ka kryer studimet pasuniversitare dhe ka marrë titull Master të Nivelit të Dytë në Shkencat Juridiko-Penale në vitin 2011, si dhe Master i Shkencave në “Legjislacion dhe Institucionet Evropiane” në vitin 2015.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, ka deklaruar se për shkak të ushtrimit të detyrës së ndihmës ligjore, përfshihet në programet e trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës dhe ka marrë pjesë në trajnimin lidhur me zhvillime të legjislacionit të prokurimeve publike dhe atij fiskal në këndvështrimin e gjykimeve administrative, çka lidhet me thellimin e njohurive të saj në fushën e të drejtës dhe të gjykimeve administrative. Gjithashtu deklaroi se ka marrë pjesë në 1 trajnim, jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, i cili është jashtë periudhës 3 vjeçare të rivlerësimit.

### **Të dhëna nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë**

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 09.07.2018, konfirmon se, sipas informacionit të kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, nuk ka procedim disiplinor.

### **❖ RIVLERËSIMI I KRITERIT ETIKO-PROFESIONAL NGA KOMISIONI**

**Nga shqyrtimi i raportit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, rezultoi se:**

**I. 3 dokumente ligjore të paraqitura** prej saj janë jashtë periudhës së rivlerësimit. Ky fakt u konfirmua nga statistikat e paraqitura për ndihmësen ligjore Miranda Nakaj, si dhe verbalisht gjatë procedurës së shortit. Këto 3 dokumente tregojnë se ajo ka trajtuar mosmarrëveshje që lidhen me dëmshpërblimin nga marrëdhëniet e punës (*shih dokumentin 1*), vlefshmërinë e titujve të pronësisë nga zbatimi i ligjit “Për tokën” (*shih dokumentin 2*) dhe procedurën administrative të të drejtës së pensionit (*shih dokumentin 3*).

### **II. Në 5 dosjet gjyqësore të shortuara:**

- a) Nuk ishte përfshirë ndonjë akt, që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin, që ndihmësja ligjore Miranda Nakaj i ka dhënë gjyqtarës B. H, lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor;
- b) Nuk ishte përfshirë përgatitja e ndonjë projekt-akti procedural të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej ndihmës ligjore Miranda Nakaj;
- c) Nuk ishte përfshirë ndonjë kërkesë nga gjyqtarja B. H drejtuar ndihmës ligjore për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, në dosje

nuk ka ndonjë akt kërkimi ligjor apo opinion me shkrim nga vetë ndihmësja Miranda Nakaj.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.07.2018, kryetari i gjykatës bën me dije se nuk ka asnjë akt tjetër procedural të hartuar nga ndihmësja ligjore, i cili nuk është administruar në dosjet gjyqësore të përzgjedhura në procedurën e shortit.

**III) Mbi konstatimet e fakteve sa më sipër, Komisioni, më datë 15.10.2018,** i kërkoi subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, të deklaroj lidhur me arsyet që kanë çuar në mospasjen e akteve procedurale të hartuar prej saj gjatë ushtrimit të detyrës si ndihmëse ligjore ne Gjykatën Administrative të Apelit si dhe si mund të evidentohet puna e saj.

Subjekti i rivlerësimit në komunikimin elektronik me Komisionin, të datës 16.10.2018, shprehet ndër të tjera se: *“Nuk ka asnjë dyshim për sa i përket evidentimit të punës time të kryer dhe konkretisht në përgatitjen e projektakteve dhe kryerjen e kërkimeve ligjore nga ana ime bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012. Shpjegoj se marrëdhënia ime e punës është i rregulluar vetëm me këtë bazë ligjore. Referuar sa sipër detyra ime funksionale si ndihmëse ligjore ka konsistuar në përgatitjen e projekt akteve procedurale të nevojshme për gjykimin si dhe me kërkesë të gjyqtarit respektiv pranë të cilëve unë jam emëruar për ndihmë (pasi secili gjyqtar ka praktikën dhe metodikën e tij të punës), kam bërë kërkime në lidhje me problematika ligjore të karakterit procedural dhe material (duke gjetur ligjin procedural dhe material, praktika gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese etj.) .”*

Subjekti i rivlerësimit vazhdon sqarimin e saj : *“Bazuar në ligjin nr. 49/2012, marrëdhënia e punës sime si ndihmës rregullohej vetëm nëpërmjet nenit 6 të tij e cila ishte lidhur ngushtësisht me gjyqtarin pranë të cilit isha emëruar, që do të thotë se për çështjet që ai planifikonte për ti shpallur për gjykim, detyra ime si ndihmëse ligjore ishte që të nxirrja faktet dhe rrethanat e çështjes përkatëse, shkaqet e ankimit dhe arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë si dhe me kërkesë të gjyqtarit të bëja kërkime ligjore në dobi të çështjes.*

*E gjithë kjo procedurë e kryer nga ndihmësit nuk rezulton të jetë plotësuar me ndonjë akt nënligjor apo me ndonjë rregullore të brendshme nga ana e gjykatës si pasojë e natyrës së ndihmës dhe vakumit ligjor të sjellë nga ligji nr. 49/2012. Shpjegoj se nuk më është kërkuar të evidentoj punën time pasi ajo ka qenë e dukshme dhe nuk është vënë asnjëherë në dyshim nga ana e gjyqtarit respektiv, gjithashtu deklaroj se nuk ka qenë e formalizuar përshkrimi i punës dhe mënyra e dokumentimit të punës për ndihmësit ligjor”.*

Shpjegimit të saj subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, i bashkëlidh ndër të tjera *e-mail-in* e datës 17.05.2016, drejtuar gjyqtares B. H, *e-mail-in* e datës 12.07.2016, drejtuar gjyqtares E. M, *e-mail-in* e datës 17.09.2018, drejtuar gjyqtarit A. Q, *e-mail-in* e datës 24.01.2018 drejtuar gjyqtares A. Q.

Në këto kushte, Komisioni, me shkresën nr. \*\*\*, datë 19.10. 2018, i kërkoi Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë hartimin e një raporti shtesë duke i bashkëlidhur kopje të *e-mail-it* të

datës 17.05.2016 drejtuar gjyqtarës B. H, si dhe të *e-mail-it* të datës 12.07.2016 drejtuar gjyqtarës E. M.

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 24.10.2018, dërgon raportin shtesë me përmbajtje si më poshtë:

**Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2018**, ka paraqitur në inspektorat, kërkesë për raport shtesë pas evidentimit të punës së kryer nga ndihmësja ligjore Miranda Nakaj dhe konfirmimit të gjyqtarëve që kanë punuar me atë gjatë periudhës së rivlerësimit, por edhe të ndonjë institucioni tjetër.

**Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2018** u kërkua konfirmimi në lidhje me pjesëmarrjen e ndihmësës ligjore Miranda Nakaj në dy çështjet gjyqësore të referuara në *e-mail-et* e datave 17.05.2016, drejtuar gjyqtarës B. H dhe të datës 12.07.2016, drejtuar gjyqtarës E. M, si dhe të dërgohej vlerësimi i këtyre dy gjyqtarëve për punën e kryer nga ndihmësja ligjore në këto 2 çështje gjyqësore, së bashku me vendimet gjyqësore përkatëse;

**Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2018**, u kërkua konfirmimi nëse ka akte të tjera në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, që përmbajnë të dhëna në lidhje me aftësitë profesionale të ndihmësës ligjore Miranda Nakaj.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2018, ka përcjellë vlerësimin e gjyqtarës E. M për ndihmësen ligjore Miranda Nakaj, 2 vendime gjyqësore nr. \*\*\*, datë 09.05.2016, dhe nr. \*\*\*, datë 30.06.2018.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2018, kopje të dy *e-mail-et* të dërguara nga ndihmësja ligjore Miranda Nakaj, të dorëzuara prej saj me dy procesverbale të datës 24.10.2018.

### **Analiza e dy çështjeve gjyqësore, ku është angazhuar ndihmësja ligjore Miranda Nakaj, paraqitet më poshtë.**

**Çështja 1.** Vendim nr. \*\*\*, datë 09.05.2016, që i përket, paditës: L. Sh kundër të paditurit: DRSSH-së Tiranë, me objekt: Shfuqizim i vendimeve të përlllogaritjes së pensionit dhe rillogaritje e pensionit të parakohshëm ushtarak.

### **Ky dokument ligjor është brenda periudhës së rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016.**

Me anë të këtij vendimi, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e përbërë nga gjyqtarët B. H (kryesuese), A. G dhe R. S ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. \*\*\*, datë 06.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke detyruar të paditurin t'i paguajë paditësit diferencën e papaguar të pensionit të parakohshëm prej 638004 lekë, si dhe pushimin e gjykimit për kërkimin tjetër të padisë.

Gjykimi i çështjes gjyqësore administrative ka zgjatur 1 vit, 11 muaj e 13 ditë në periudhën 26.05.2014 - 09.05.2016, jashtë afatit 1 mujor të përcaktuar neni 48, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Këtij vendimi, ndihmësja ligjore Miranda Nakaj, i ka bashkëlidhur një kopje të printuar të *e-mail-it* që ka dërguar nga adresa elektronike e pakuptueshme tek adresa e pritësit. Ky *e-mail* është

përcjellë, më datë 17.05.2016, ora 05:19, PM - pra pas 8 ditëve nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 7 ditor të përcaktuar nga neni 55 pika 3 e ligjit nr. 49/2012.

Këtij *e-maili* i është bashkëlidhur kopja e vendimit gjyqësor të gjyqtares B. H, gjithsej 22 fletë. Vendimi është i strukturuar në 3 pjesë: pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit. Pjesa përshkruese-arsyetuese është e pandarë në pjesë. Pjesa arsyetuese fillon me marrëdhënien juridike mes palëve, si dhe konfliktin e krijuar për të cilin është ngritur edhe kërkesëpadia. Më pas, ka paraqitur arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas disponimit të gjykatës duke paraqitur argumentet me shkrim të diferencuar të pjerrtë (*italic*) të futur në thonjëza, ku vihet re se është paraqitur gjithë pjesa vëren e vendimit të shkallës së parë, gjithsej 5 faqe. Po në të njëjtën mënyrë është vepruar dhe me paraqitjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, gjithsej 2 faqe. Me paragraf veçuar me hapësirë dhe filluar me shkrim *bold* të nënvizuar “padiësi L. Sh”, ndihmësja ka paraqitur pretendimet e padiësit fjalë për fjalë, ashtu siç janë paraqitur parashtrimet e padiësit për seancën gjyqësore, madje duke përdorur edhe fjalët “të nderuar anëtarë të trupit gjykues” dhe “znj/z Kryetar”, të cilat në disa raste janë lënë të tilla dhe në vendimin përfundimtar të gjyqtares B. H. Më tej, po me paragraf veçuar me hapësirë dhe filluar me shkrim *bold* të nënvizuar “i padituri DRSSH Tiranë”, ndihmësja ka paraqitur pretendimet e të paditurit fjalë për fjalë siç janë parashtrimet e paraqitura prej tij për seancën gjyqësore. Në fund të pjesës arsyetuese gjendet një fjali me përmbajtjen se “shpenzime gjyqësore lidhur me këtë çështje në Gjykatën e Apelit Administrativ nuk u kryen”.

**Vendimi i paraqitur nga ndihmësja ligjore nuk ka nënshkrimin me cilësinë e konceptueses prej ndihmësës ligjore. Po ashtu, nuk ka asnjë akt pranimi nga gjyqtarja B. H, që të konfirmojë se në hartimin e këtij vendimi, ka kontribuar ndihmësja ligjore Miranda Nakaj.**

Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe rregullt. Janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, por nuk janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, konkretisht karakteri ‘ë’. Vendimi është 22 faqe.

Nga krahasimi i vendimit të dërguar prej ndihmësës ligjore dhe vendimit përfundimtar të dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me kryesuese gjyqtaren B. H, ka disa ndryshime të lehta që konsistojnë si më poshtë:

- i) Në pjesën hyrëse ka ndryshim fjalësh mbi gjykimin me dyer të hapura apo mbi kohën e paraqitjes së ankimit prej padiësit. Megjithatë, këto ndryshime nuk janë thelbësore;
- ii) Në pjesën arsyetuese, mungon analiza ligjore e cila në vendim është paraqitur me shkrim *bold* me nënvizim “Arsyetimi i Kolegjit të Gjykatës së Apelit Administrativ”. Në vendimin përfundimtar të gjyqtares, janë gjithsej 4 faqe që i dedikohen analizës ligjore, ligjit të zbatueshëm dhe konkluzioneve;
- iii) Dispozitivi i vendimit është i njëjtë.

**Çështja 2.** Vendimi gjyqësor nr. \*\*\*, datë 30.06.2016, që i përket, paditësve: E. T, M. A dhe Urdhri i Farmacistëve, kundër: të paditurit FSDKSH-së Tiranë, me objekt: Shfuqizim i pjesëshëm i aktit administrativ - vendim nr. \*\*\*, për kriteret e farmacive.

Lidhur me *e-mail-in* e datës 12.07.2016, dërguar gjyqtarës E. M, në procesverbalin e paraqitur nga vetë subjekti, më datë 24.10.2018, rezulton se materiali i dërguar gjyqtarës nuk është përgatitur prej saj, por i është dërguar gjyqtarës praktika e Gjykatës Administrative të Apelit në lidhje me një çështje analoge, sipas kërkesës verbale të gjyqtarës.

**-Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.10.2018, gjyqtarja E. M ka kthyer përgjigje në inspektorat se:** *“Në lidhje me përgatitjen e projektakteve nga ana e ndihmësit ligjor Miranda Nakaj, përgjatë periudhës 01.07.2016 - 21.09.2018, koha e dorëzimit të tyre ka qenë gjithmonë brenda afateve të komunikuara nga ana ime në mënyrë verbale, diktuar nga ngarkesa e punës. Vlen për t’u theksuar se të gjitha projektaktet e përgatitura nga ndihmësja ligjore në mbështetje të punës sime kanë qenë gjithmonë të një cilësie shumë të lartë. Ndhmësja ligjore Miranda Nakaj, përveç përgatitjes së projektakteve, me kërkesën verbale të gjyqtarit, ka kryer detyra të tjera si evidentim të praktikave të Gjykatës Kushtetuese, vendim unifikues të Gjykatës së Lartë, si dhe praktika të Gjykatës Administrative të Apelit në lidhje me çështje analoge”.*

**-Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2018, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë** ka dërguar pranë Komisionit, shkresën e gjyqtarës B. H ku informon ndër të tjera se puna e ndihmësës ligjore Miranda Nakaj, nuk e kaloi kurrë në asnjë rast nivelin e përgatitjes së projekt relacioneve dhe projektvendimeve. Gjithashtu gjyqtarja H. bën me dije se papërgjegjshmëria në punë është reflektuar në mënyrë sistematike nga ndihmësja ligjore Miranda Nakaj, dhe është evidentuar nga znj. H. në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 05.05.2016, drejtuar kryetarit të Gjykatës Administrative dhe konsiston në faktin se përkundër të qenurit ndihmë, puna e ndihmësës ka qenë barrë për të.

**-Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2018, Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë** dërgon pranë Komisionit të gjitha aktet e deklaruara nga ndihmësi ligjor Miranda Nakaj, në format elektronik dhe të përfshira në një CD si akte të punuara prej saj për periudhën 10 qershor 2015 - dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2018, nga Gjykata Administrative e Apeli Tiranë.

**-Në datën 2 nëntor 2018 subjekti i rivlerësimit,** ndër të tjera ka dërguar shpjegime me *e-mail* në lidhje me vlerësimin e gjyqtarës relatores ku ka punuar përgjatë periudhës, 10.06.2015 - 01.07.2016, duke sqaruar se ka punuar në tension psikologjik të vazhdueshëm dhe nën ndikimin e fjalorit të ulët, dhe për këtë arsye ka kërkuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.03.2016, kalimin pranë një gjyqtari tjetër. Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 01.07.2016, të kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit, është emëruar pranë një gjyqtare tjetër relatores, detyrë që e ka ushtruar deri në qershor të vitit 2018. Kjo mënyre punë kishte qenë edhe me ndihmësen ligjore pasardhëse.

### **Rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës**

Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.05.2018, ka dërguar rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuar në nenin 179/b, pika 4 të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Rezulton se, me vendimin e

Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, nr. \*\*\*, datë 21.05.2018, janë miratuar rezultatet e të dy fazave të testimit, për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, zhvilluar nga kjo shkollë në datat 7 - 8 maj të vitit 2018. Nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, ka marrë 61 pikë nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë ka marrë 139 pikë nga 200 të mundshme. Ndërsa me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.09.2018, Shkolla e Magjistraturës na konfirmon se, në mbështetje të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, bën pjesë në subjektet të cilët kanë marrë të paktën 60 % të pikëve në testimin e aftësive profesionale dhe se ka të drejtë të ndjek programin 2-vjeçar të trajnimit teorik dhe të praktikës profesionale në Shkollën e Magjistraturës. Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2018, Shkolla e Magjistraturës ka konfirmuar se, bazuar në pikën 4, të nenit 65, të ligjit nr. 96/2016, znj. Miranda Nakaj, bën pjesë në subjektet e rivlerësimit *ex officio* që ka plotësuar deklaratën duke shprehur vullnetin për të ndjekur programin e trajnimit 2-vjeçar dhe se ka në nënshkruar marrëveshjen e regjistrimit pranë kësaj shkolle.

## **KONKLUZIONE PËR KOMPONENTIN E VLERËSIMIT PROFESIONAL**

Subjekti i rivlerësimit për shkak të detyrës ‘*ndihmëse ligjore*’ “pranë Gjykatës Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet bazuar:

*a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollën e Magjistraturës.*

**Lidhur me vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të vlerësimit sipas pikës a)** trupi gjykues bazuar në (i) konstatimet e mësipërme dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se;

Sipas ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” marrëdhënia e punës së ndihmësit ligjor bazohet në nenin 6 të tij “... gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkollës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor. Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projekt-akte procedurale të nevojshme për gjykimin. Me kërkesë të gjyqtarit, ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinione me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim”.

Sikurse referohet nga dispozita ligjore, evidentimi i punës së subjektit të rivlerësimit është e lidhur me gjyqtarin relator, sipas kërkesave të këtij të fundit.

Referuar raportit të vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ndër të tjera evidentohet fakti se, kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës Administrative të Apelit.



Trupi gjykues, gjatë analizimit të fakteve për shkaqet ligjore dhe objektive lidhur me, mungesën e kuadrit ligjor në fuqi për përcaktimin e standardeve minimale të punës për ndihmësin ligjor, si dhe mbi qëndrimet e ndryshme të gjyqtarëve relatores, konkludon se:

**Vlerësimi i kriterit profesional, mbështet dhe duhet të mbështetet, në analizimin e projekt-akteve të hartuara prej saj, për aq sa qe e mundur, në çmuarje të burimeve të rivlerësimit sipas nenit 42 të ligjit nr. 84/2016.**

Trupi gjykues, referuar nenit 41, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 “...*Periodha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Në rast se subjekti i rivlerësimit ka më pak se 3 vite në detyrë, periodha e vlerësimit konsiderohet e gjithë koha gjatë ushtrimit të detyrës*”, **çmon se në vlerësimin profesional për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, duhet të merret në konsideratë e gjithë periodha e ushtrimit të detyrës, në të cilën janë analizuar edhe aktet e hartuara nga ana e saj, sikurse rezulton edhe qëndrimi pozitiv nga gjyqtarja tjetër relatores.**

Gjithashtu, trupit gjykues, gjatë vlerësimit profesional të këtij subjekti, mbajti në konsideratë, edhe faktin se nuk i rezultuan të dhëna<sup>10</sup>, për procedim disiplinor.

**Në vlerësim të burimit të rivlerësimit, sipas pikës 2, germa “b”, të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Shkolla e Magjistraturës, në mbështetje të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, ka të drejtë të ndjek programin dyvjeçar të trajnimit teorik dhe të praktikës profesionale në Shkollën e Magjistraturës.**

**Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues pas propozimit të relatores së çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të nenit 59 germa “c” të ligjit nr. 84/2016.**

## **V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

---

<sup>10</sup> Refero shkresën nr. \*\*\* prot., datë 09.07.2018, të Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Nakaj, me funksion ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Vazhdimin e programit 2-vjeçar të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.
3. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

*U shpall në Tiranë, më datë 08.11.2018.*

### **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Roland ILIA**  
Kryesues

**Xhensila PINE**  
Anëtare

**Brunilda BEKTESHI**  
Relatore

*Sekretare gjyqësore*  
*Anisa Duka*